



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1527/12 prot

Datë 15.06.2026

V E N D I M
Nr. 800/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.06.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur – Mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-84346-05-05-2026 me objekt: “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote, për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit 111,841,711.14 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë pikë katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1,167,450.01 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë zero një) euro pa TVSH, LOT 2 - MM2 “Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, me nr. REF-84350-05-05-2026 me fond limit 56,985,144.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH ose 594,834.49 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme

Ankimues: Operatori ekonomik “SoLed” SHPK me NIPT M42026032D dhe adresë: Kompleksi Lake View, Rruga Kristo Luarasi, Godina B, Kati 4, Hyrja B03, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.05.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E Hapur – Mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-84346-05-05-2026 me objekt: “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote, për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit 111,841,711.14 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë pikë katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1,167,450.01 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë zero një) euro pa TVSH, LOT 2 - MM2 “Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, me nr. REF-84350-05-05-2026 me fond limit 56,985,144.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH ose 594,834.49 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..

II.2. Në datën 18.05.2026.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë administruar ankesat me numër ankimi elektronik A/2026/6666; A/2026/6667; A/2026/6668; A/2026/6669; A/2026/6670 dhe me nr. 1527; 1527/1; 1527/2; 1527/3; 1527/4 prot., datë 18.05.2026 e operatorit ekonomik “SoLed” SHPK me anë të së cilës ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

[.....]Në dokumentat e tenderit është përcaktuar:

2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

LOT 2 - MM2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore: 56,985,144.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH ose 594,834.49 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë) euro pa TVSH.

Kërkojmë që të sistemohet vlera në fjalë ën mënyrë që mos të krijohet konfuzion tek operatorët ekonomik.

Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda nje periudhe 24 mujore,si me poshte:

Periudha 12 mujore e I-re

Deri në 35% të sasive - 4 mujorin e I

Deri ne 35 % të sasive - 4 mujorin e II

Deri në 30 % të sasive - 4 mujorin e III

Periudha 12 mujore e II-te

Deri në 35% të sasive - 4 mujorin e I

Deri ne 35 % të sasive - 4 mujorin e II

Deri në 30 % të sasive - 4 mujorin e III

Përrjashtimisht këtij përcaktimi, autoritetet kontraktore mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për artikujt e listës së planifikuar, që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në cdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do të përcaktohen sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Së pari kërkojmë që të përputhet vlera numerike me shifrën me fjalë pasi ka mospërputhje midis tyre.

Për të garantuar kohë të mjaftueshme për përgatitjen dhe furnizimin e mallrave, kërkojmë që në dokumentacion të përcaktohet qartë se çdo porosi apo kërkesë për lidhje kontratë, duhet t'i njoftohet operatorit ekonomik fitues së paku 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së dorëzimit të mallrave. Ky afat është i nevojshëm për të garantuar kohë të mjaftueshme për përgatitje dhe furnizim: ky afat minimal ofron operatorëve mundësinë të organizojnë zinxhirin e furnizimit, të sigurojnë kapacitetet prodhuese dhe logjistike, të përpunojnë dokumentacionet e nevojshme dhe të shmangin rreziqet e vonësive apo kostove shtesë; në të njëjtën kohë, procedura e qartë dhe e parashikueshme rrit konkurrencën e drejtë dhe shmang praktikën e ndryshimit të kushtëzimit të kontratave në mënyrë arbitrare.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e shenjuar me asterisk (*) në formularin e specifikimeve teknike (Shtojca nr. 6). Mostra duhet të paraqitet në paketimin origjinal sipas prodhuesit.

- *Mostrat do të paraqiten pranë organit qendror blerës "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" SHA në datën dhe orën e hapjes së procedurës, me adresë: Rr "Reshit Çollaku", Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).*

Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit, "Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim" dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, gjykojmë, se për kriterin në fjalë nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë argument teknik, se përse kërkohet paraqitja e mostrave sikurse parashikohet në pikën 1 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 03, datë 12.04.2022, "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë" dhe për më tepër ky kriter është një kriter i dubluar dhe që krijon kosto të shtuara për operatorët ekonomikë, pasi në "Kapaciteti teknik" të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor për të krijuar bindjen se produktet e ofruara nga operatorët ekonomik ofertues do të jenë sipas specifikimeve teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, ka përcaktuar që këta ofertues të paraqesin katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar dhe në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur, prandaj autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin kualifikues të përcaktuar në "Kapaciteti teknik" të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, për paraqitjen e mostrave, pasi nuk e ka argumentuar nga

ana teknike vendosjen e këtij kriteri.

Nga ana tjetër është e pamundur për OE të sjellin mostrat pasi:

- koha është shumë e shkurtër nga dhënia e porosisë deri në prodhimin e tyre (pasi janë disa prodhues dhe shumica e tyre nuk i kanë stok këto materiale duke qënë se ka materiale me skadencë të shkurtër), dhe transportin deri në destinacion,

- kostoja e lartë të transportit që rritet ditë për ditë, çka rrit koston e blerjes së mostrave dhe humbje të mëdha ekonomike për OE në rast të mos-shpalljes fitues,

- Pra është e qartë se mostrat "do ti sjellë" OE i cili e ka gjendje mallin.

Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e tij nr. 1289/2025 datë 22.09.2025 ka vendosur pranimin e pretendimit të ankimuesit duke hequr kërkesën për paraqitjen e mostrave.

Po ashtu Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës në procedurën e prokurimit me nr

REF-46920-05-05-2025 me objekt "Loti 1 (MM1) Materiale mjekësore të përgjithshme" në bazë të sugjerimit të APP-se me email dt. 13.05.2025 e ka hequr këtë kriter kualifikimi.

Artikulli nr 37 me specifikime teknike: Sonde Blakemore: - Nr. 16, 20

Në kuadër të pjesëmarrjes sonë në tenderin për furnizimin e materialeve mjekësore, dëshirojmë t'ju informojmë lidhur me situatën e ofertimit për produktin Sonde Blakemore dhe pengesat objektive ligjore dhe teknike që e bëjnë të pamundur sigurimin e këtij artikulli në tregun shqiptar. Specifikimet aktuale të tenderit, në praktikë, kufizojnë ndjeshëm konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë, pasi produkti i kërkuar korrespondon me një produkt shumë specifik, i cili në tregun shqiptar dhe rajonal disponohet ekskluzivisht nga shoqëria Euromed Shpk, me prodhues Create Medic.

Nga verifikimet dhe informacionet e disponueshme në treg rezulton se prodhues të tjerë që mund të ofrojnë produkte të ngjashme nuk disponojnë certifikimin CE të vlefshëm për këtë produkt, çka i bën ato produkte të papranueshme për përdorim dhe ofertim në procedura publike sipas kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi për pajisjet mjekësore.

Sipas Rregullores (EU) 2017/745, një pajisje mjekësore mund të hidhet në treg vetëm nëse certifikata CE është lëshuar nga një trup i notifikuar i autorizuar nga BE dhe i regjistruar në NANDO. Certifikatat CE të lëshuara nga subjekte jo të regjistruara në NANDO nuk njihen në Shqipëri. Pasojat janë:

1. Produktet nuk mund të regjistrohen në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), pasi Blakemore Probe është pajisje klasa IIA. Kjo e bën të pamundur çdo proces importi.
2. Produkti nuk mund të konsiderohet i legalizuar për përdorim në spitale apo në institucione publike.
3. Importi ose përdorimi i produktit me certifikatë të pavlefshme do të përbënte shkelje të Ligjit dhe udhëzimeve të MSHMS, duke sjellë rrezik sanksionesh administrative dhe penale.
4. Për pasojë, dokumentacioni i kërkuar për pjesëmarrje në tender është i paplotësueshëm, duke e bërë të pamundur ofertimin për këtë artikull.

Situata aktuale në treg: I vetmi prodhues që plotëson kërkesat ligjore për tregtimin e këtij produkti është Create Medic. Nga komunikimi me këtë prodhues (email-i bashkëlidhur), jemi informuar se për territorin e Shqipërisë ekziston një distributor ekskluziv i autorizuar, gjë që e bën të pamundur furnizimin e produktit përmes kompanisë sonë.

Gjithashtu është kontaktuar Distributori MedFirst i cili në përgjigjen e tij në email thekson se nuk është i autorizuar për të shitur produktin në territorin e Shqipërisë dhe referon që të kontaktohet prodhuesi Create Medic, i cili në vetvete referon se nuk është i autorizuar për të shitur produktin pasi ka një distributor ekskluziv në territorin e Shqipërisë (e-mail i bashkangjitur).

Verifikimi pranë AKBPM konfirmon se "Euromed" Shpk rezulton distributori i vetëm i regjistruar për këtë artikull me prodhues Create Medic me numer identifikimi 13867 dhe rrjedhimisht i vetmi furnitor në Shqipëri që disponon autorizim prodhuesi, pasi pa autorizim prodhuesi nuk lejohet

rregjistrimi i produkteve tek AKBPM. Kështu që, pjesëmarrja jonë ? dhe e çdo operatori tjetër përveç distributorit ekskluziv ? është objektivisht e pamundur.

Kjo krijon një situatë ku procedura është de facto e paracaktuar për kompaninë Euromed Shpk (në bashkim operatorësh me "OES Distrimed" shpk), si i vetmi operator që mund të sigurojë produktin.

Theksojmë se në këtë rast nuk bëhet fjalë për një preferencë tregtare apo zgjedhje subjektive nga ana jonë, por për një pamundësi objektive dhe ligjore për të siguruar produktin nga

kompani të tjera. Për sa kohë që prodhuesit alternativë nuk disponojnë certifikim CE, ne si operator ekonomik nuk mund të importojmë, ofertojmë apo paraqesim produkte të tjera, edhe nëse ato mund të kenë përdorim të ngjashëm klinik.

Në këto kushte, kërkojmë ndarjen e këtij artikulli në një lot të veçantë, pasi:

? Produkti ka një sasi minimale prej vetëm 140 copësh dhe një vlerë të ulët njësi (rreth 5,000 lekë/copë),

? Përfshirja e tij brenda lotit aktual paracakton një procedurë me vlerë : 56.985.144 lekë të reja

? vetëm një BOE (OES Distrimed shpk dhe Euromed shpk), të cilët prej vitesh paraqiten si bashkim operatorësh, mund ta furnizojnë artikullin.

? Nuk ekziston një produkt ekuivalent që të zëvendësojë këtë produkt.

? Kjo situatë sjell mungesë të konkurrencës së lirë dhe të ndershme, si dhe krijon një avantazh të padrejtë për operatorin që zotëron të drejtën ekskluzive të importit.

Në Vendimin nr. 157/2025, datë 24.12.2025 të KSHA-së për procedurën e prokurimit me Nr. REF-70413-11-26-2025 dhe object “Blerje material mjekimi kosnumabël dhe kirurgjikale MM2”, AK përfitues: Spitali Korçë duke vlerësuar të drejtë ankesën tonë e hoqi këtë produkt nga kërkesa për prokurim, duke e vendosur sasinë 0 (zero).

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin numër 117,118,119

117 Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting Copë 12

118 Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point Copë 12

119 Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point Copë 12

Nga analiza teknike dhe verifikimet e kryera rezulton se kombinimi i mësipërm i karakteristikave:

? absorbim 180 ditë;

? copolymer glycolic acid dhe trimethylene carbonate;

? strukturë me luspa/barbs unidirectional përgjatë gjithë fijos;

? loop/lak në fund;

? konfigurimi specifik i gjatësisë dhe ages;

korrespondon praktikisht vetëm me produkte të kompanisë Medtronic.

Në mbështetje të këtij fakti, ne kemi kontaktuar kompani ndërkombëtare të specializuara në prodhimin e suturave kirurgjikale, përfshirë kompanitë Vitrex dhe Jost, të cilat në përgjigjet e tyre zyrtare me email konfirmojnë se produkti me këto specifikime identifikohet si produkt specifik i Medtronic. Këto komunikime janë bashkëlidhur si prova dokumentare.

Gjithashtu, nga verifikimi në regjistrin zyrtar të AKBPM rezulton se produktet përkatëse të Medtronic janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë nga kompania OES Distrimed, e cila rezulton distributori zyrtar/ekskluziv për territorin shqiptar.

Ne kemi kryer tentativa të përsëritura për kontakt direkt me kompaninë Medtronic, nëpërmjet

email-eve dhe komunikimeve zyrtare, me qëllim sigurimin e ofertës dhe aksesit në produkt. Megjithatë, nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga kompania Medtronic, çka demonstroi në praktikë pamundësinë e aksesit të operatorëve të tjerë ekonomikë të ky produkt jashtë kanalit ekskluziv të distributorit zyrtar në Shqipëri.

Bashkëlidhur këtij ankimi gjenden:

? emaillet e dërguara Medtronic;

? mungesa e përgjigjeve nga kompania;
? komunikimet me kompani të tjera ndërkombëtare që konfirmojnë ekskluzivitetin praktik të produktit.

Në këto kushte rezulton qartë se:

- ? specifikimet teknike nuk përfaqësojnë një standard të hapur tregu;
- ? por çojnë objektivisht në identifikimin e një produkti të vetëm;
- ? të një prodhuesi të vetëm (Medtronic);
- ? dhe të një distributori të vetëm në Shqipëri (OES Distrimed).

Gjithashtu, ne sjellim në vëmendje edhe faktin se për këtë produkt është kërkuar një sasi minimale prej vetëm 12 copësh, ndërkohë që për produktet e tjera të ngjashme në procedurë kërkohej sasi ndjeshëm më të larta.

Ky element demonstroi se produkti nuk përfaqëson nevojë reale dhe proporcionale furnizimi në raport me produktet e tjera dhe është përfshirë në mënyrë të tillë që të krijojë kusht kufizues për pjesëmarrjen në tender duke vendosur operatorët ekonomikë në kushte konkurrence të pabarabartë.

Në praktikë, përfshirja e një produkti ekskluziv krijon efekt bllokues për operatorët e tjerë ekonomikë, pasi pamundësia për të siguruar një produkt specifik të kontrolluar nga një distributor i vetëm çon automatikisht në skualifikim nga procedura, pavarësisht aftësisë për të furnizuar pjesën tjetër të produkteve të tenderit.

Për rrjedhojë, specifikimet aktuale kufizojnë konkurrencën reale, favorizojnë një operator ekonomik të vetëm, krijojnë kushte diskriminuese dhe konkurrence të pabarabartë dhe bien ndesh me parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të parashikuara në legjislacionin e prokurimit publik.

Në mbështetje të faktit se ekzistojnë produkte ekuivalente që përmbushin të njëjtin funksion klinik dhe kirurgjikal, kompania jonë ka kontaktuar prodhues të tjerë ndërkombëtarë të specializuar në sutura kirurgjikale, të cilët kanë konfirmuar mundësinë e ofrimit të produkteve zëvendësuese ekuivalente.

Konkretisht, një nga kompanitë e kontaktuara ka konfirmuar se disponon në portofolin e saj sutura PDO Barbed (BDO), me karakteristika si më poshtë:

- ? material Polydioxanone (PDO);
- ? strukturë monofilament me barbs/luspa;
- ? konfigurim me barbs unidirectional ose bidirectional;
- ? mundësi furnizimi me dy age ose me lak në fund;
- ? madhësi nga USP 5/0 deri USP 3;
- ? profil absorbimi afatgjatë rreth 180-210 ditë. Kompania në fjalë ka konfirmuar gjithashtu se:

? produkti i saj dhe produkti i kërkuar në specifikimet e tenderit i përkasin të njëjtës kategori funksionale të suturave absorbueshme monofilament me barbs për mbyllje kirurgjikale pa nyje (knotless soft tissue approximation);

? të dy produktet janë:

- o monofilament;
- o absorbues;
- o barbed sutures;
- o knotless closure systems;
- o dhe produkte për mbështetje afatgjatë të indeve në aplikime kirurgjikale të

krahasueshme.

Sipas konfirmimit të prodhuesit, diferenca kryesore ndërmjet produktit të tyre dhe produktit të kërkuar lidhet vetëm me përbërjen e polimerit dhe profilin e degradimit, por jo me funksionin themelor kirurgjikal të produktit.

Sa i përket kërkesës për gjatësi 60 cm, kompania ka sqaruar se aktualisht portofoli standard disponohet në gjatësi 45 cm, e cila rekomandohet edhe nga vetë prodhuesi për shkak të kontrollit më të mirë të tensionit dhe manovrimit më komod gjatë procedurës kirurgjikale.

Sipas konfirmimit të prodhuesit:

? diferenca në gjatësi nuk ndikon në funksionin klinik të produktit;

? ndërsa të gjitha karakteristikat e tjera të specifikimit korrespondojnë me konfigurimin e produktit të tyre.

Për rrjedhojë, ekzistenca e produkteve ekuivalente që kryejnë të njëjtin funksion klinik dhe kirurgjikal demonstroi se autoriteti kontraktor duhet të lejojë produkte ekuivalente dhe të mos kufizojë specifikimet teknike vetëm në konfigurimin ekskluziv të produktit Medtronic.

Si alternativë teknike dhe funksionale, propozojmë që specifikimet të bëhen:

117 Suture Sintetike e absorbueshme 180-210 dite, USP 3-0 Me përbërje Polydioxanone (PDO), me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting Copë 12

118 Suture Sintetike e absorbueshme 180-210 dite, USP 3-0 Me përbërje Polydioxanone (PDO), me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point Copë 12

119 Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 1/2, 37mm, taper point Copë 12

Artikulli 161 me specifikime teknike: Stapler rrethor 25 mm / 28 mm / 31 mm ? stapler njëpërdorimësh rrethor 28 mm, gjatësia e boshtit 22 cm dhe me kapëse 4.8 mm në formë drejtkëndore, anvili të jetë me mekanizëm tilt”.

Pas verifikimit teknik dhe krahasimit me katalogët zyrtarë të prodhuesve ndërkombëtarë, rezulton se këto specifikime përputhen në mënyrë specifike me produktin EEA? Circular Stapler ëith DST Series? Technology të kompanisë Medtronic/Covidien.(Katalogu i bashkangjitur)

Në katalogun zyrtar të Medtronic referohen qartë:

? diametrat 25 mm, 28 mm dhe 31 mm;

? staple height/open height 4.8 mm;

? shaft length 22 cm;

? Tilt-Top anvil mechanism.

Këto karakteristika teknike identifikuese gjenden të publikuara në dokumentacionin teknik zyrtar të Medtronic. Për rrjedhojë, formulimi aktual i specifikimeve kufizon konkurrencën dhe favorizon praktikisht vetëm operatorët ekonomikë që tregtojnë produktet Medtronic, konkretisht distributorin OES Distrimed.

Gjithashtu në faqen zyrtare të Agjensisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore akbpm.gov.al mund të shihet qartë që e gjithë gama e produktit EEA Circular Stapler ëith DST Series është e regjistruar me numrin identifikues 16530 nga operatori ekonomik OES Distrimed shpk dhe rrjedhimisht i vetmi furnitor në Shqipëri që disponon autorizim prodhuesi, pasi pa autorizim prodhuesi nuk lejohet rregjistrimi i produkteve tek AKBPM.

Ky fakt bie ndesh me parimin e mosdiskriminimit, parimin e konkurrencës së lirë, parimin e proporcionalitetit dhe kërkesën ligjore që specifikimet teknike të mos referojnë një markë, origjinë apo model specifik, përveç rasteve kur justifikohet objektivisht dhe shoqërohet me termin “ose ekuivalent”.

Në lidhje me sigurimin e produktit të kërkuar në procedurën e prokurimit, sqarojmë se bëhet fjalë për një produkt ekskluziv të kompanisë Medtronic, produktet e së cilës rezultojnë të regjistruara

pranë AKBPM në emër të operatorit ekonomik OES Distrimed shpk.

Kjo situatë krijon një kufizim objektiv të aksesit për operatorët ekonomikë të tjerë, pasi furnizimi dhe tregtimi i këtyre produkteve lidhet drejtpërdrejt me distributorin që disponon regjistrimin dhe autorizimin përkatës.

Kompania jonë ka kontaktuar në mënyrë të përsëritur kompaninë Medtronic, si edhe përfaqësuesit/distributorët përkatës, me qëllim sigurimin e mundësisë së furnizimit dhe bashkëpunimit për produktin në fjalë. Megjithatë, pavarësisht kërkesave dhe komunikimeve të vazhdueshme, deri në këtë moment nuk kemi marrë asnjë përgjigje apo mundësi bashkëpunimi nga ana e tyre (email bashkangjitur)

Për pasojë, duke qenë se produkti është ekskluziv dhe produktet Medtronic rezultojnë të regjistruara pranë AKBPM në emër të OES Distrimed, kompania jonë nuk ka pasur mundësi reale dhe efektive për sigurimin e këtij produkti, çka ka kufizuar objektivisht pjesëmarrjen tonë në procedurën e prokurimit.

Në treg ekzistojnë prodhues të tjerë ndërkombëtarë të staplerëve kirurgjikalë me certifikime CE/MDR, të cilët ofrojnë produkte funksionalisht ekuivalente, por që përjashtohen për shkak të parametrave tepër specifikë të vendosur në dokumentet e tenderit.

Si alternativë teknike dhe funksionale, propozojmë:

Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm Stapler një-përdorimesh rrethor 28mm, gjatësia e boshtit 49.2 cm dhe me kapëse 4.8mm në formë drejtëkëndore, anvili të jetë me mekanizëm tilt Edhe pse gjatësia e boshtit të produktit të propozuar (49.2 cm) është më e madhe se ajo e produktit Medtronic (22 cm), kjo diferencë nuk cenon funksionin klinik të produktit, nuk ndryshon mekanizmin e anastomozës, nuk ndikon në cilësinë, uniformitetin apo integritetin e staple line.

Gjatësia e boshtit nuk është parametër kritik i performancës së anastomozës, pasi nuk ndikon në formimin e kapëseve (staples), nuk ndikon në presionin e mbylljes, nuk ndikon në sigurinë mekanike të lidhjes

Përkundrazi, ka avantazh pasi ofron fleksibilitet më të madh operacional, mundëson qasje më të lehtë në zona anatomike të thella (pelvis, abdomen i thellë), nuk pengon përdorimin në raste më sipërfaqësore.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se specifikimet aktuale janë të personalizuar për një produkt dhe një distributor të vetëm, produkti i propozuar nga ana jonë kryen të njëjtin funksion kirurgjikal, me të njëjtën siguri dhe efikasitet klinik dhe dallimi në gjatësinë e boshtit nuk përbën mospërputhje teknike, por një variacion të pranueshëm dhe funksional.

Në përputhje me parimet e prokurimit publik, produkti alternativ duhet të konsiderohet ekuivalent dhe i pranueshëm, ndërsa refuzimi i tij për shkak të gjatësisë së boshtit përbën kufizim të pajustificuar të konkurrencës.

Për këtë arsye kërkojmë:

1. Rishikimin dhe ndryshimin e specifikimeve teknike;
2. Heqjen e parametrave identifikues specifikë që korrespondojnë me një produkt të vetëm;
3. Përdorimin e specifikimeve funksionale dhe klinike, duke lejuar ofertimin e produkteve ekuivalente;

Artikulli 162: Stapler Endoskopie - Stapler njëpërdorimesh i rikarikueshem, gjatesia e boshtit 16cm dhe 6cm, artikulacion +/-45 grade dhe me 11 pozicione

Nga verifikimi i kryer në katalogë zyrtarë të prodhuesve ndërkombëtarë të staplerëve endoskopikë rezulton se nuk ekziston asnjë stapler endoskopie që ofron 11 pozicione artikulimi të kartrixhit. Ky parametër nuk paraqitet në asnjë dokumentacion teknik të verifikueshëm dhe për rrjedhojë përbën

një të dhënë të pasaktë dhe jo standarde, duke e bërë specifikimin të paqartë dhe potencialisht kufizues.

Përdorimi i një karakteristike teknike që nuk ekziston realisht në treg cenon parimin e specifikimeve të qarta, të sakta dhe të verifikueshme, siç kërkohet nga legjislacioni i prokurimit publik.

Propozojmë që produkti të këtë specifikimet si më poshtë:

Stapler Endoskopie Stapler njeperdorimesh i rikarikueshem, gjatesia e boshtit 16cm dhe 6cm, artikulacion +/-45 grade dhe me 7 pozicione

Kërkesa për 11 pozicione artikulimi nuk mbështetet në produkte reale të disponueshme në treg, nuk sjell asnjë avantazh klinik të provuar dhe përbën një specifikim të pasaktë dhe të pajustifikuar teknikisht.

Nga pikëpamja klinike, parametrat kryesorë që përcaktojnë performancën e një stapleri endoskopik janë:

- ? aftësia për akses adekuat në fushën kirurgjikale;
- ? mundësia e orientimit të kokës së instrumentit;
- ? stabiliteti gjatë staplimit;
- ? kompresioni korrekt i indeve;
- ? formimi i sigurt i vijës së staplimit;
- ? ergonomia dhe kontrolli intraoperativ.

Produkti i propozuar nga ana jonë i përmbush plotësisht këto kërkesa funksionale dhe klinike, pasi:

- ? disponon të njëjtin kënd artikulimi 45°;
- ? ka të njëjtën gjatësi boshti 16 cm dhe 6 cm;
- ? është njëpërdorimësh dhe i rikarikueshëm;
- ? siguron orientim dhe akses adekuat intraoperativ;
- ? realizon të njëjtin funksion kirurgjikal dhe të njëjtin rezultat klinik.

Numri i pozicioneve të artikulimit përfaqëson një karakteristikë teknike ergonomike të prodhuesit dhe jo një kriter që përcakton drejtpërdrejt suksesin klinik të ndërhyrjes. Në praktikën kirurgjikale, funksioni kryesor i artikulimit është mundësimi i orientimit të instrumentit në hapësira anatomike të kufizuara. Ky funksion realizohet plotësisht edhe me 7 pozicione artikulimi. Për rrjedhojë, produkti i propozuar duhet të konsiderohet teknikisht ekuivalent dhe i pranueshëm, ndërsa specifikimi aktual duhet të korrigjohet për të garantuar konkurrencë reale dhe respektim të parimeve të prokurimit publik.

Në bazë të specifikimit për artikulacionin +/-45 gradë, 7 këndet e artikulimit janë në -45°, -30°,

-15°, 0°, +15°, +30°, +45°.

Artikulli 170: Elektroda me maje Maryland, nje-perdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut, 23cm- Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade, gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja.

Specifikimet teknike të kërkuara korrespondojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me produktin ekskluziv të kompanisë Covidien e cila tashme prej vitesh është pjesë e Medtronic, konkretisht linjën e produkteve LigaSure Maryland Jaë Sealer-Divider me kod reference LF1723 (Katalogu bashkangjitur)

Kombinimi shumë specifik i karakteristikave teknike, si:

- ? maja Maryland;
- ? sealing deri në 7 mm;
- ? gjatësi 23 cm;
- ? rrotullim 350°;

? gjatësi nifulle 20 mm;
? prerje 18 mm;
? thikë e integruar e pavarur nga mekanizmi i sealing;
identifikon praktikisht një konfigurim të vetëm prodhuesi dhe nuk përfaqëson një standard të

përgjithshëm teknik të tregut.

Nga verifikimet tona rezulton se produktet Medtronic për këtë kategori janë të regjistruara pranë AKBPM me numer identifikimi 9030 në emër të operatorit ekonomik OES Distrimed shpk, i cili vepron si distributor i autorizuar/OE për këto produkte në tregun shqiptar dhe rrjedhimisht i vetmi furnitor në Shqipëri që disponon autorizim prodhuesi, pasi pa autorizim prodhuesi nuk lejohet rregjistrimi i produkteve tek AKBPM.

Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë të tjerë nuk kanë akses real furnizimi tek ky produkt, pasi:

- ? produkti është ekskluziv;
- ? kanalet e furnizimit kontrollohen nga distributori i autorizuar;
- ? regjistrimi pranë AKBPM lidhet me OE përkatës;

Kompania jonë ka tentuar të kontaktojë në mënyrë të përsëritur kompaninë Medtronic dhe përfaqësuesit/distributorët përkatës për të siguruar mundësinë e furnizimit apo bashkëpunimit për këtë produkt, por pa marrë përgjigje apo mundësi aksesimi. (email-i bashkangjitur)

Në këto kushte, specifikimet teknike të hartuara në këtë formë krijojnë një situatë përjashtuese dhe kufizojnë objektivisht pjesëmarrjen tonë në procedurën e prokurimit, pasi praktikisht vetëm operatori ekonomik që disponon ekskluzivitetin dhe regjistrimin përkatës ka mundësi reale ofertimi në këto rast OES Distrimed

Për më tepër, kërkesat tepër specifike teknike nuk lidhen domosdoshmërisht me një avantazh klinik proporcional, por identifikojnë indirekt një produkt dhe prodhues të vetëm, (e provuar me email dhe nga kompani të tjera prodhuese) duke cënuar parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

Gjithashtu, theksojmë se formulimi i specifikimeve teknike në këtë mënyrë bie ndesh me parimet dhe dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik, pasi specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë që:

- ? të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për hapjen e prokurimit ndaj konkurrencës;
- ? të mos favorizojnë apo referojnë indirekt një markë, prodhues apo distributor të caktuar;

? të garantojnë trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë. Përcaktimi i karakteristikave tepër specifike, të cilat në praktikë identifikojnë vetëm një produkt të Medtronic, krijon një situatë monopol faktik dhe cenon konkurrencën reale në procedurë.

Referuar parimeve të legjislacionit të prokurimit publik, autoriteti kontraktor duhet të formulojë specifikimet teknike mbi bazën e funksionalitetit dhe performancës klinike të produktit, duke lejuar edhe produkte ekuivalente që realizojnë të njëjtin funksion mjekësor dhe kirurgjikal.

Në rastin konkret, kërkesat aktuale tejkalojnë nevojën funksionale dhe teknike të autoritetit kontraktor dhe për pasojë kufizojnë padrejtësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të tjerë në procedurë.

Pavarësisht pamundësisë objektive për të siguruar produktin ekskluziv të kompanisë Medtronic, kompania jonë është në gjendje të ofrojë një produkt ekuivalent, i cili përmbush të njëjtin funksion klinik dhe kirurgjikal, si dhe garanton performancë, siguri dhe efektivitet të njëjtë në përdorim.

Produkti qe ne propozojmë është: Elektrode me majë Maryland, njëpërdorimshe, për mbylljen e enëve të gjakut deri në/përfshirë 7 mm, 23 cm, për prerje/devaskularizim organesh, e rrotullueshme 350°, me gjatësi nofullë 20 mm, prerje 18.4 mm dhe me thikë të integruar të pavarur nga mekanizmi i ngjitjes

Ky produkt përmbush plotësisht funksionin klinik dhe kirurgjikal të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi garanton:

- ? mbyllje efektive të enëve të gjakut deri në 7 mm;
- ? prerje dhe devaskularizim të sigurt të indeve;
- ? kontroll të mirë intraoperativ;
- ? përdorim të përshtatshëm në procedurat laparoskopike dhe kirurgjikale;
- ? siguri, hemostazë dhe performancë klinike ekuivalente

Theksojmë se diferenca ndërmjet gjatësisë së prerjes 18 mm të kërkuar në specifikimet teknike dhe gjatësisë së prerjes 18.4 mm të produktit të ofruar nga ana jonë nuk përbën ndryshim thelbësor teknik apo klinik. Kjo diferencë minimale prej vetëm 0.4 mm nuk ndikon në funksionin kirurgjikal të instrumentit, në efektivitetin e prerjes apo në performancën e sealing-ut të enëve të gjakut.

Produkti i ofruar realizon të njëjtin funksion klinik dhe garanton të njëjtin nivel sigurie, hemostaze dhe efikasiteti gjatë procedurës kirurgjikale. Në praktikën kirurgjikale dhe në vlerësimin teknik të pajisjeve mjekësore, diferenca të tilla minimale dimensionale konsiderohen brenda tolerancave normale teknike të prodhuesve dhe nuk përbëjnë element që ndryshon përdorimin apo rezultatin klinik të produktit.

Për rrjedhojë, produkti i ofruar nga kompania jonë duhet të konsiderohet ekuivalent funksional dhe klinik me specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin numër 171

171 Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehyde-Formaldehyde Per dezinfektimin manual të instrumenteve kirurgjikale, perfishire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfshire HBV/HIV) Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perftimin e solucionit te gatshem per perdorim. Permbajtja: min. 2% glutaraldehyde, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve litra 500

Vlerësojmë se kërkesa për përmbajtje Formaldehyde nuk është e domosdoshme, kufizon konkurrencën dhe nuk është në përputhje me praktikat moderne të sigurisë në shëndetësi.

1. Rrezikshmëria e Formaldehyde

Formaldehyde klasifikohet ndërkombëtarisht si substancë kancerogjene për njerëzit (IARC Group 1 dhe CLP Regulation EC 1272/2008). Përdorimi i tij në ambiente spitalore lidhet me:

- ? irritim të rrugëve të frymëmarrjes, syve dhe lëkurës;
- ? reaksione alergjike dhe dermatite profesionale;
- ? ekspozim të vazhdueshëm të personelit shëndetësor ndaj avujve toksikë;
- ? rrezik afatgjatë për sëmundje serioze, përfshirë forma të caktuara të kancerit.

2. Praktika bashkëkohore dhe tregu ndërkombëtar

Kompanitë kryesore ndërkombëtare në fushën e high-level disinfection kanë kaluar në formulime pa Formaldehyde, duke përdorur alternativa më të sigurt si:

- ? Glutaraldehyde pa Formaldehyde;
- ? Ortho-Phthalaldehyde (OPA);
- ? Peracetic Acid;
- ? Hydrogen Peroxide;
- ? dhe përbërje të tjera ekuivalente dezinfektuese.

Gjithashtu, shumë kompani që ne kemi kontaktuar rekomandon zgjidhje pa Formaldehyde, duke reflektuar praktikën moderne të reduktimit të rrezikut kimik në mjediset spitalore. (Bashkëngjitur kemi edhe një deklaratë teknike të kompanisë Russon që tregon për rrezikshmërinë e produktit).

3. Disponueshmëria dhe konkurrenca në treg

Formulimet me Glutaraldehyde pa Formaldehyde janë gjerësisht të disponueshme në tregun ndërkombëtar dhe ofrohen nga një numër i madh prodhuesish të njohur. Këto produkte:

- ? realizojnë të njëjtin funksion dezinfektues;
- ? kanë të njëjtin spektër veprimi (baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral);
- ? janë të certifikuara për përdorim në instrumente kirurgjikale, endoskope dhe fibroskope. Prandaj, heqja e Formaldehyde nuk kufizon konkurrencën, por përkundrazi e zgjeron atë duke lejuar pjesëmarrjen e më shumë prodhuesve ndërkombëtarë.

Në këto kushte, kërkesa për “Glutaraldehyde-Formaldehyde”:

- ? nuk përbën domosdoshmëri teknike;
- ? krijon rrezik të panevojshëm për personelin shëndetësor;
- ? kufizon konkurrencën dhe përjashton produkte moderne të disponueshme gjerësisht në treg.

Për rrjedhojë, kërkojmë:

- ? heqjen e Formaldehyde nga specifikimi teknik;
- ? dhe lejimin e produkteve ekuivalente “Glutaraldehyde pa Formaldehyde”

Si alternativë teknike dhe funksionale, propozojmë që specifikimet të bëhen:

171 Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehyde Për dezinfektimin manual të instrumenteve kirurgjikale, përfshirë endoskopet dhe fibroskopet. Të ketë efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (përfshirë HBV/HIV). Përmbajtja: min. 2% glutaraldehyde, etj. Të furnizohet si solucion i gatshëm për përdorim (max 5 litra/ene). litra 500

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin numër 174

174 Detergjent Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti përmban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isothiazolinone Magnesio Cloruro, përdoret duke u tretur 20 ml në 1 liter ujë litra 500

Kërkesa për përfshirjen e “2% Isothiazolinone Magnesium Chloride” kufizon konkurrencën dhe nuk është në përputhje me parimet e sigurisë kimike dhe legjislacionit për substancat e rrezikshme. Sipas Rregullores (EC) Nr. 1272/2008 (CLP) për klasifikimin dhe etiketimin e substancave kimike, si dhe praktikave të sigurisë në BE, substancat e grupit Isothiazolinone njihen si irrituese për lëkurën dhe sytë, sensibilizuese alergjike dhe me potencial për reaksione dermatologjike në ekspozim të përsëritur profesional.

Për këtë arsye, në formulimet moderne të dezinfektantëve profesionalë, shumë prodhues ndërkombëtarë kanë reduktuar ose eliminuar përdorimin e këtyre përbërjeve, duke kaluar në alternativa më të sigurta dhe të certifikuara.

Nga verifikimet e tregut rezulton se shumica e kompanive ndërkombëtare përdorin formulime të bazuara në:

- ? Quaternary Ammonium Compounds (QAC);
 - ? Didecyldimethylammonium Chloride (DDAC);
 - ? Benzalkonium Chloride;
 - ? ose kombinime të tjera ekuivalente dezinfektuese,
- të cilat realizojnë plotësisht efektin baktericid, fungicide, virucidal, pa nevojën e përfshirjes së Isothiazolinone Magnesium Chloride.

Gjithashtu, prania ose mungesa e këtij komponenti nuk ndikon në funksionin themelor të produktit, pasi dezinfektimi i sipërfaqeve mund të realizohet në mënyrë të plotë me formulime alternative të aprovuara ndërkombëtarisht.

Në këto kushte, kërkesa specifike për “2% Isothiazolinone Magnesium Chloride”:

- ? nuk përbën domosdoshmëri teknike;
- ? kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën;
- ? dhe përjashton produkte moderne dhe të sigurt të disponueshme gjerësisht në treg.

Për rrjedhojë, kërkojmë:

- ? heqjen e kërkesës për “2% Isothiazolinone Magnesium Chloride”;
- ? dhe lejimin e produkteve ekuivalente me bazë QAC, DDAC ose përbërje të tjera dezinfektuese të certifikuara.

Propozojmë që specifikimi të formulohet si më poshtë:

“Detergjent/dezinfektant për dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshëm të sipërfaqeve, planeve sanitare, dyshemeve dhe objekteve, me efekt baktericid, fungicid dhe virucidal, me bazë Quaternary Ammonium Compounds (QAC), DDAC ose përbërje të tjera ekuivalente dezinfektuese, i përshtatshëm për përdorim profesional dhe sipas udhëzimeve të prodhuesit.”

Ky ndryshim:

- ? rrit sigurinë kimike për përdoruesit;
- ? harmonizohet me legjislacionin dhe praktikën bashkëkohore të BE;
- ? dhe zgjeron ndjeshëm konkurrencën në procedurën e prokurimit publik. Si alternativë teknike dhe funksionale, propozojmë që specifikimet të bëhen:

174 Detergjent Detergjent/dezinfektant për dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshëm të sipërfaqeve, planeve sanitare, dyshemeve dhe objekteve, me efekt baktericid, fungicid dhe virucidal, me përbërje aktive bazuar në Didecyl Dimethyl Ammonium Chloride, Dimethylbenzyl Ammonium Chloride, Bis (3-aminopropyl) dodecylamine, Nonionic Surfactants, materiale antikorrozive dhe ujë të dejonizuar ose përbërje të tjera ekuivalente dezinfektuese, i përshtatshëm për përdorim profesional dhe hollim sipas rekomandimit të prodhuesit litra 500

Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se specifikimet teknike janë hartuar në kuadër të një katalogu të standardizuar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, sqarojmë se një standardizim i tillë nuk e përjashton detyrimin ligjor për respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në këtë kuadër, fakti që specifikimet janë pjesë e një katalogu të standardizuar:

- nuk i jep atyre karakter të pakontestueshëm ligjërësht;
- nuk i përjashton nga kontrolli i ligjshmërisë;
- dhe nuk justifikon vendosjen e kërkesave që kufizojnë konkurrencën.

Referuar nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë që:

- të mundësojnë trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë;
- të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën;
- dhe të jenë të bazuara në karakteristikën funksionale ose standarde të hapura.

Në rastin konkret, edhe pse në mënyrë formale nuk janë përmendur marka, prodhues apo referenca specifike, niveli i lartë i detajimit dhe kombinimi unik i karakteristikave teknike për disa produkte:

- identifikon në mënyrë indirekte një produkt të vetëm;
- rrjedhimisht një prodhues të vetëm;
- dhe në tregun shqiptar një distributor të vetëm të autorizuar.

Kjo përbën një formë të referimit të fshehtë (indirekt) ndaj një produkti specifik, e cila është po aq kufizuese sa referimi i drejtpërdrejtë i markës dhe bie ndesh me frymën dhe qëllimin e nenit 36 të ligjit për prokurimin publik.

Për më tepër, nga verifikimet tona dhe dokumentacioni i paraqitur në këtë ankesë, është provuar se:

- produktet e identifikuarat përmes këtyre specifikimeve disponohen vetëm nga një prodhues i caktuar;
- dhe në Republikën e Shqipërisë furnizohen në mënyrë ekskluzive nga një operator ekonomik i vetëm.

Në këto kushte, edhe pse formalisht nuk është përmendur marka, efekti praktik i specifikimeve është identik me një procedurë të paracaktuar, duke eliminuar çdo mundësi reale konkurrence. Gjithashtu, theksojmë se këto specifikime nuk reflektojnë një analizë të hapur dhe gjithëpërfshirëse të tregut, por rezultojnë të jenë hartuar mbi baza të informacionit të marrë nga operatorë ekonomikë të caktuar, përfshirë distributorë ekskluzivë, pa u marrë në konsideratë:

- ekzistenca e produkteve ekuivalente;
- standardet ndërkombëtare të hapura;
- dhe nevoja për të garantuar akses të barabartë në procedurë.

Një praktikë e tillë bie në kundërshtim me parimin e neutralitetit teknik dhe krijon një situatë ku specifikimet teknike projektohen mbi produktin ekzistues të një operatori dhe jo mbi nevojën funksionale të autoritetit kontraktor.

Më tej, një element tjetër thelbësor që provon karakterin kufizues të këtyre specifikimeve është fakti se për produktet në fjalë janë kërkuar sasi minimale, kur në momentin që fitohet procedura nga ky Bashkim Operatorësh ekonomikë këto produkte nuk porositen fare.

Këto produkte:

- nuk përfaqësojnë nevojë reale dhe proporcionale institucionale;
- nuk justifikojnë teknikisht përfshirjen e produkteve kaq specifike në një lot me vlerë të lartë;
- dhe në praktikë krijojnë një efekt bllokues të pjesëmarrjes, pasi pamundësia për të siguruar një produkt të vetëm çon në skualifikimin e ofertuesit për të gjithë lotin.

Ky mekanizëm përbën një formë të ngushtimit artificial të konkurrencës, në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 162/2020, pasi:

- procedura strukturohet në mënyrë të tillë që favorizon një operator të vetëm;
- ndërkohë që operatorët e tjerë, edhe pse të aftë për të furnizuar pjesën dërrmuese të artikujve, përjashtohen për shkak të një numri të kufizuar produktesh specifike.

Për rrjedhojë, standardizimi i specifikimeve teknike:

- nuk mund të përdoret si justifikim për vendosjen e kritereve diskriminuese;
- nuk mund të prevalojë mbi parimet themelore të prokurimit publik;
- dhe duhet të rishikohet në çdo rast kur prodhon efekte kufizuese në konkurrencë. Në përfundim, specifikimet teknike në formën aktuale:

- janë joproportionale me nevojat reale të autoritetit kontraktor;
- identifikojnë në mënyrë indirekte produkte dhe operatorë të caktuar;
- dhe krijojnë një procedurë me konkurrencë të kufizuar ose formale. Për këto arsye, kërkojmë:

- rishikimin dhe ndryshimin e specifikimeve teknike për produktet përkatëse;
 - formulimin e tyre mbi bazë funksionale dhe standardesh të hapura;
 - dhe lejimin efektiv të produkteve ekuivalente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mosndërhyrja në këtë situatë do të përbënte një legjitimim të një praktike që, edhe pse e paraqitur si “standardizim”, në realitet prodhon efekte përjashtuese dhe favorizuese, në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.....”[.....]

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 2233/6 prot., datë 22.05.2026, të ardhur nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, protokolluar me tonën me nr. 1527/5 prot., datë 25.05.2026 me objekt *“Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur ng operatori ekonomik “SoLed” SHPK, lidhur me dokumentet e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-84350-05-05-2026026, me objekt: “LOT 2 - MM2 “Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, autoriteti kontraktor njofton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas shqyrtimit të ankesës ka vendosur të ndërpresë afatin 5-ditor për marrjen e vendimit në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK deri në marrjen e një informacioni nga autoriteti kontraktor përfitues Spitali Rajonal Shkodër.*

E njëjta shkresë është dërguar nëpërmjet shërbimit postar dhe protokolluar me tonën nr.1527/6, datë 25.05.2026.

II.5. Më datë 26.05.2026, operatori ekonomik ka ngarkuar në sistemin elektronik të ankesave dokumenta plotësuesë protokolluar me tonën me nr.1527/7.

II.6. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave autoriteti kontraktor me shkresës nr. 2233/10 prot, datë 04.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1527/8 prot, datë 05.06.026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së nr.91/2026, datë 03.06.2026.

E njëjat shkresë dhe vendim i KSHA-së është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën 1527/9 prot., datë 08.06.2026

Referuar vendimit të KSHA-së konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke pranuar kërkesat si më poshtë:

“1- Lidhur me pretendimin e ankimuesit “SoLed” shpk mbi korigjimin e vlerës së fondit limit shprehur me fjalë, KSHA arsyeton se:

Në dokumentet standarte të tenderit, Seksioni 2, pika 2.14 “Përshkrimi i shkurtër i Loteve”, është përcaktuar se:

LOT2 - MM2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore. • 56,985, 144 00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH one 594,834. 49 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë) euro pa TVSH.

Nga shqyrtimi i kërkesës për prokurim të dërguar nga Autoriteti Kontraktor përfitues, protokolluar pranë OBP me nr.1638 prot., datë 02.04.2026, rezulton se fondi limit për Lotin 2 — “MM2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” është 56,985,144.00 (pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH. KSHA vlerëson se në dokumentet e tenderit të ngarkuar në SPE ka një lapsus të vlerës numerike të fondit limit në monedhën Lekë të shprehur me fjalë, ndaj ngarkohet Njësia e Prokurimit të kryejë modifikimet e nevojshme në mënyrë që të mos ketë mospërputhje midis vlerës së fondit limit shprehur me shifra dhe asaj me fjalë.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

2- Në lidhje me specifikimet teknike për artikujt numër 117, 118, 119:

Specifikimet teknike për artikujt numër 117, 118, 119 modifikohen si vijon:

117	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, ose ekuivalent me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting
118	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, ose ekuivalent me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point
119	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, ose ekuivalent me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm +/-10%, age 1/2, 37mm +/-10%, taper point

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht

3- Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin numër 161:

Sa më sipër, në kuadër të rritjes së konkurrencës dhe mundësinë e ofertimit nga sa më shumë operatorë ekonomikë vendas apo ndërkombëtarë, SRSH vendos të mos e marrë në Considerate sugjerimin e OE ankimues mbi tjetërsimin e specifikimit teknik mbi gjatësinë e boshtit por pranon cdo material të ngjashëm duke modifikuar gjatësinë e boshtit në një diapazon të lejueshëm me devijim afërsisht 10% pa cënuar specifikimet fillestare të kërkuara.

4 - Specifikimet teknike për artikullin nr.161 modifikohen si vijon:

161	Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm	Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm +/-10% dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekeendore, anvili te jete me mekanizem tilt	Copë	24
------------	------------------------------------	---	------	----

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht

5- Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin numër 162:

Specifikimet teknike për artikullin nr.162 modifikohen si vijon:

162	Stapler Endoskopie	Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekendore, anvili te jete me mekanizem tilt dhe me te pakten 7 pozicione
------------	--------------------	---

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

6- Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin numër 170:

Specifikimet teknike për artikullin nr.170 modifikohen si vijon:

170	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut , 23cm	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade, gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm +/-10%, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja.
------------	---	--

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. nr. 2233/10 prot, datë 04.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1527/8 prot, datë 05.06.2026 dhe nr. 1527/9 prot., datë 08.06.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së ku konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke pranuar kërkesat si më poshtë:

“1- Lidhur me pretendimin e ankimuesit “SoLed” shpk mbi korigjimin e vlerës së fondit limit shprehur me fjalë, KSHA arsyeton se:

Në dokumentet standarte të tenderit, Seksioni 2, pika 2.14 “Përshkrimi i shkurtër i Loteve”, është përcaktuar se:

LOT2 - MM2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore. • 56,985, 144 00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH one 594,834. 49 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë) euro pa TVSH.

Nga shqyrtimi i kërkesës për prokurim të dërguar nga Autoriteti Kontraktor përfitues, protokolluar pranë OBP me nr.1638 prot., datë 02.04.2026, rezulton se fondi limit për Lotin 2 — “MM2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” është 56,985,144.00(pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH. KSHA vlerëson se në dokumentet e tenderit të ngarkuar në SPE ka një lapsus të vlerës numerike të fondit limit në monedhën Lekë të shprehur me fjalë, ndaj ngarkohet Njësia e Prokurimit të kryejë modifikimet e nevojshme në mënyrë që të mos ketë mospërputhje midis vlerës së fondit limit shprehur me shifra dhe asaj me fjalë.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

2- Në lidhje me specifikimet teknike për artikujt numër 117, 118, 119:

Specifikimet teknike për artikujt numër 117, 118, 119 modifikohen si vijon:

117	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, ose ekuivalent me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting
118	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, ose ekuivalent me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point
119	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, ose ekuivalent me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm +/-10%, age 1/2, 37mm +/-10%, taper point

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht

3- Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin numër 161:

Sa më sipër, në kuadër të rritjes së konkurrencës dhe mundësinë e ofertimit nga sa më shumë operatorë ekonomikë vendas apo ndërkombëtare, SRSH vendos të mos e marrë në Considerate sugjerimin e OE ankimues mbi tjetërsimin e specifikimit teknik mbi gjatësinë e boshtit por pranon cdo material të ngjashëm duke modifikuar gjatësinë e boshtit në një diapazon të lejueshëm me devijim afërsisht 10% pa cënuar specifikimet fillestare të kërkuara.

4 - Spcifikimet teknike për artikullin nr.161 modifikohen si vijon:

161	Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm	Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm +/-10% dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekendore, anvili te jete me mekanizem tilt	Copë	24
------------	------------------------------------	--	------	----

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht

5- Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin numër 162:

Specifikimet teknike për artikullin nr.162 modifikohen si vijon:

162	Stapler Endoskopie	Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekendore, anvili te jete me mekanizem tilt dhe me te pakten 7 pozicione
------------	--------------------	--

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

6- Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin numër 170:

Specifikimet teknike për artikullin nr.170 modifikohen si vijon:

170	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut , 23cm	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade, gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm +/-10%, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja.
------------	---	--

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi

i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;

b) pranimin e pjesshëm të ankesës;

c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shkresa e autoritetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim të pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik “SoLed” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesat me nr.1527,1527/1,1527/2,1527/3,1527/4 prot., datë 18.05.2026, të operatorit ekonomik “SoLed” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “SoLed” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, konkretisht të grafikut të lëvrimit me arsyetimin se : “...Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoritetet kontraktore mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për artikujt e listës së planifikuar, që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në cdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do të përcaktohen sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Për të garantuar kohë të mjaftueshme për përgatitjen dhe furnizimin e mallrave, kërkojmë që në dokumentacion të përcaktohet qartë se çdo porosi apo kërkesë për lidhje kontrate, duhet t'i njoftohet operatorit ekonomik fitues së paku 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së dorëzimit të mallrave. Ky afat është i nevojshëm për të garantuar kohë të mjaftueshme për përgatitje dhe furnizim: ky afat minimal ofron operatorëve mundësinë të organizojnë zinxhirin e furnizimit, të sigurojnë kapacitetet prodhuese dhe logjistike, të përpunojnë dokumentacionet e nevojshme dhe të shmangin rreziqet e vonësive apo kostove shtesë; në të njëjtën kohë, procedura e qartë dhe e parashikueshme rrit konkurrencën e drejtë dhe shmang praktikën e ndryshimit të kushtëzimit të kontratave në mënyrë arbitrare.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, . autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon::

Shtojca 7.

[...]

Afatet e lëvrimit:

Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda një periudhe 24 mujore, si me poshte:

Periudha 12 mujore e I-re

- Deri në 35% të sasive - 4 mujorin e I
- Deri në 35 % të sasive - 4 mujorin e II
- Deri në 30 % të sasive - 4 mujorin e III

Periudha 12 mujore e II-te

- Deri në 35% të sasive - 4 mujorin e I
- Deri në 35 % të sasive - 4 mujorin e II
- Deri në 30 % të sasive - 4 mujorin e III

Përfundimisht këtij përcaktimi, autoritetet kontraktore mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për artikujt e listës së planifikuar, që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimin do të përcaktohen sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

III.2.2. Nëpërmjet shkresës nr. 2233/10 prot, datë 04.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1527/9 prot, datë 08.06.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së i cili ndër të tjera ka vendosur mos pranim për këtë kërkesë të operatorit ekonomik ankimes me arsyetimin se “Nga korrespondenca zyrtare e OBP sha me Autoritetin Kontraktor Përfitues, ky i fundit nëpërmjet shkresës me Nr. 1556/2 Prot. datë 28.05.2026 (regjistruar në OBP sha me Nr. 2233/8 Prot. datë 01.06.2026) ka argumentuar si më poshtë vijon: Ne lidhje me pretendimin e miisiperm Autoriteti Kontraktor Përfitues sqaron si me poshte; AK Spitali Rajonal i Shkodres gjykon se pretendimi lidhur me grafikun e levrimit nuk qendron pasi per funksionimin normal te sherbimeve spitalore eshte e domosdoshme dhe e nevojshme furnizimi brenda 30 diteve nga neshkrimi i minikontratave deri ne 10% e sasise se planifikuar ne grafikun e levrimit. AK do te paraqese kerkesen per oferte per lidhjen e minikontrates jo me pak se 30 dite”.

III.2.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin

fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin

mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III. 2.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.6. Në lidhje me vendimin e mësipërm të KSHA-së për mospranimin dhe modifikimin e kërkesës që në dokumentacion të përcaktohet qartë se: “çdo porosi apo kërkesë për lidhje kontrate duhet t'i njoftohet operatorit ekonomik fitues të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së dorëzimit të mallrave, me qëllim garantimin e kohës së mjaftueshme për përgatitje dhe furnizim”, KPP-ja gjykon se kjo kërkesë është e ekzagjeruar. Ky vlerësim bazohet në faktin se afati i lëvrimin të përcaktuar në Shtojcën 7 të DST-së për sasi të caktuara është 120 ditë (4 muaj). Për më tepër, ky afat fillon të rrjedhë pas përfundimit të procedurës së minikonkurrit dhe shpalljes së fituesit, çka nënkupton se operatori ekonomik ka kohë të mjaftueshme për sigurimin dhe furnizimin e mallit. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se objekti i këtij prokurimi konsiston në furnizimin me artikuj mjekësorë. Nisur nga nevojat imediate dhe jetike të institucioneve shëndetësore për këto produkte, çdo vonesë në furnizimin e tyre do të passillte pasoja kritike, deri në kolaps total

të shërbimit shëndetësor. Referuar natyrës së mallrave objekt prokurimi, Komisioni çmon se objekti i këtij prokurimi nuk është një mall i zakonshëm tregtar, por artikuj mjekësorë të domosdoshëm për funksionimin e përditshëm të institucioneve shëndetësore. Imponimi i një afati njoftimi prej 45 ditësh përpara çdo dorëzimi do të lidhte duart e spitaleve në raste të emergjencave mjekësore. Vonesat e tilla burokratike në furnizim do të cenonin drejtpërdrejt shëndetin e pacientëve dhe do të çonin në kolaps total të shërbimit shëndetësor.

Fakti që këto mallra sigurohen nga importi nuk e shkarkon operatorin ekonomik nga përgjegjësia. Një ofertues serioz, në momentin që shpallet fitues dhe nënshkruan kontratën, duhet të koordinojë zinxhirin e tij të furnizimit për të garantuar mallin sipas grafikëve të Autoritetit Kontraktor. Kushtëzimi me afate të ekzagjeruara 45-ditore përbën tentativë për të justifikuar vonesat dhe për të abuzuar me afatet e lëvrimin në dëm të interesit publik.

Nisur nga sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për përcaktimin e afatit njoftues 45-ditor është e pabazuar, e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me natyrën urgjente të shërbimit shëndetësor

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “SoLed” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, duke kërkuar heqjen e mostrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera:

“9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e shenjuar me asterisk (*) në formularin e specifikimeve teknike (Shtojca nr. 6). Mostra duhet të paraqitet në paketimin origjinal sipas prodhuesit.

- *Mostrat do të paraqiten pranë organit qendror blerës “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” SHA në datën dhe orën e hapjes së procedurës, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e OBP-së, në adresën “Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)”. Mosparaqitja e mostrave sipas kërkeses dhe specifikimeve teknike perben shkak per skualifikim.”*

III.3.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) autoriteti kontraktor ka argumentuar në lidhje me vendosjen e këtij kriteri kualifikues të pikës 2.3.

“Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8/2 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbështetje te nenit 77 të LPP dhe pikes 6 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. Ky kriter gjithashtu gjen mbështetje në Udhëzimin e APP nr. 3, datë 12.04.2022 ‘Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE’. Paraqitja e mostrave per artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise ne vend te materialeve objekt prokurimi qe operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 6, dhe duke qene se ato kane nje natyre te vecante, per te rritur efikasitetin e vlerësimit të mallrave, u gjykua e nevojshme të bëhet edhe një vlerësim në vend, për disa prej tyre. Përzgjedhja e artikujve për të cilët do të paraqitet mostër, u bë bazuar në sasinë e tyre dhe janë zgjedhur vetëm artikuj që kërkohej të prokurohen në sasinë mbi 10,000 (dhjetë mijë) njësi. Referuar numrit të lartë të kërkuar për këta artikuj, u gjykua e arsyeshme të verifikohen në vend modelet e ofertuara, që të shihet me përpikmëri përmbushja e specifikimeve teknike, krahas vlerësimit nga katalogu dhe dokumentacioni tjetër teknik i kërkuar për mallrat. Sa më sipër, duke u bazuar në natyrën specifike të artikujve objekt prokurimi, kjo kërkesë gjendet në proporcion me objektin e prokurimit dhe e bazuar në ligj..”

III.3.3. Në shtojcën nr. 7 të dokumenteve të tenderit “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

LOT 2 MM2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore

Nr.	Emërtimi i	Specifikimet Teknike	Njësia	Sasia per
-----	------------	----------------------	--------	-----------

	artikujve			24 muaj
Materiale mjekimi per Anestezi -reanimacion				
1	Kanjule intravenoze	14G , me valvol	Copë	100
2	Kanjule intravenoze	16G , me valvol	Copë	500
3*	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë	70,000
4*	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë	25,000
5*	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë	40,000
6	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë	4,000
8	Age spinale e zakonshme	22G - 26G, L=7-9 cm	Copë	2,500
9	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë	500
11	Kateter zgjatues venoz	Zgjatues 120-150cm	Copë	1,000
12	Ventil tre-rrugesh		Copë	200
13	Ventil tre-rrugesh me zgjatues	Tub 10-25 cm gjatesi	Copë	400
15*	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë	19,000
16	Kateter Foley 3-rruge	Silikon Foley Ped-adult 3-rruge	Copë	300
18	Sonde gastrike		Copë	2,000
19	Sonde rektale		Copë	50
20	Sonde rektale pediatrike		Copë	50
21*	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë	19,000
22	Qese urine pediatrike	jo më shumë se 1000ml, me valvol	Copë	200
23	Age spinale pediatrike		Copë	20
24	Set aspirimi kanjule me tub	1.8 deri 2.5 m+kanjule 26X6 mm	Copë	2,500
26	Kanjule trakeostomie 100% silikon	7,7.5,8,8.5 mm me ballon	Copë	30
31	Kateter urinar	2 rrugesh, 12 ch, balon 10 ml	Copë	200
	Kateter urinar	2 rrugesh, 16 ch, balon 30 -50 ml	Copë	200

32				
35	Kateter urinar	2 rrugesh, 14 ch, balon 30-50 ml	Copë	200
37	Sonde blakemore	Nr. 16, 20	Copë	140
38	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm	Copë	500
40	Sfungjer Nazal me fill	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm	Copë	20
41	Splint Intranazal Silikoni	Splint Intranazal Silikoni me tub ajrimi	Copë	20
Shiringa, Age				
42	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë	3,000
43*	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë	300,000
44*	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë	360,000
45*	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë	400,000
46*	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë	40,000
47	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G	Copë	3,000
48	Age 18G	sterile	Copë	300
49	Age 20G	sterile	Copë	300
57	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile me gryke hinke	Copë	1,000
Materiale nje perdorimeshe per kirurgji				
59	Perparese vizitoresh	Perparese vizitoresh me peshe jo me pake se 20 gr , me minge elastike dhe jake rrethore	Copë	2,000
60	Maske kirurgjikale	Cope e pathurur me 3 shtresa, celluloze , poliester , fiber , koficenti i filtrimit $\geq 99\%$, me pershtates per hundën dhe lidhese , dimesionet 90 mm x 180 mm , pesha 2.8 gr	Copë	5,000

63	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike	Copë	2,000
66	Beze kirurgjikale sterile 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m2, me permassa te copes 75x90cm	Copë	3,000
70	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetike) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashe qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent	Copë	200
Materiale qepes kirurgjikale				
Sutura mendafshi				
72	Silk -USP 1, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	7,000
73	Silk -USP 0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	7,000
74	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë	300
75	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-35	age 1/2 rrethore	Copë	2,000
76	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40	age 1/2 rrethore	Copë	500
77	Silk -USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-25	age 1/2 rrethore	Copë	500
78	Silk -USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore	Copë	3,000

79	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese	Copë	500
80	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë	500
81	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	500
82	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-26	me age 1/2 rrethore	Copë	100
84	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	100
85	Silk -USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 16-20	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	60
93	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	1,000
Sutura Sintetike te Absorbueshme				
94*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	13,000
95*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	13,000
96*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë	17,000

97*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë	17,000
98	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë	7,000
99	Poliglctin ose PGA , Coated-USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë	400
100	Poliglctin ose PGA , Coated-USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë	200
117	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithë trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting	Copë	12
118	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithë trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point	Copë	12
119	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithë trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point	Copë	12
Suture Polipropileni				-
120	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë	1,500
121	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50 mm	1/2 rrethore shpuese	Copë	500

123	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë	2,000
124	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 40-50cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	600
125	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë	6,000
126	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	600
127	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë	4,500
128	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	500
129	Polypropylene-USP4-0, Gjatesia fijes 60-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë	400
131	Polypropylene-USP 5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	120
Sutura PVDF				
140	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 6/0	0.7 metric, reverse premium cutting, 12mm 3/8 circle, length 45 cm	Copë	120
Sutura PVDF e verdhe				-

146	Monofilament PVDF I verdhe e pa absorbueshme USP 2/0	3 metric, reverse cutting, 25mm 1/2 circle, length 76 cm	Copë	60
147	Monofilament PVDF I verdhe, e pa absorbueshme USP 4/0,	1.5 metric, A-cute taper, 20mm 1/2 circle, length 90 cm	Copë	60
148	Monofilament PVDF I verdhe, e pa absorbueshme USP 3/0,	2 metric, Round bodied taper, 16mm 1/2 circle, length 45 cm	Copë	60
149	Shirit Polyester i pa absorbueshme per serklazh 0.5cm	Per tarjtimin e qafes se mitres gjate shtatezanise sipas teknikes Shirodkar, gjatesi 50cm, me dy age 65mm ne te dy anet e shiritit	Copë	80
Mesh kirurgjikal per hernia-laparaskopi				
151	Mesh e vogel	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2	Copë	120
152	Mesh e madhe	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron	Copë	60
Sutura per okulistike				
156	Polyamide 6 dhe 66- USP 10-0, Gjatesia e fijes 30- 45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm	spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double	Copë	60
157	Polyamide 6 dhe 66- USP 9-0, Gjatesia e fijes 30- 45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm	spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double	Copë	30
158	Polypropylene- USP 6-0; Gjatesia e fijes 75 cm, Dimensioni i ages 13 mm	3/8 rrethore	Copë	48

Te tjera materiale qepes kirurgjikale				
160	Stapler	Linear 30/60/90 mm	Copë	20
161	Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm	Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekendore, anvili te jete me mekanizem tilt	Copë	24
162	Stapler Endoskopie	Stapler njeperdorimesh i rikarikueshem, gjatesia e boshtit 16cm dhe 6cm, artikulacion +/-45 grade dhe me 11 pozicione	Copë	3
163	Stapler linear preres	60-80 mm	Copë	10
165	Kartrixh per Stapler Endoskopie	Kartrixh i artikuluar me tre rrjeshta me lartesi te ndryshme (2;2.5;3mm dhe 3;3.5;4mm), 30mm;45mm;60mm	Copë	30
166	Aplikator automatik klipash	Medium	Copë	50
167	Elektroda, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut ne forme gershere	Elektroda, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm. Prerje (devaskularizimi i organeve), me maje te harkuar, thike te integruar te pavarur nga ngjitja, me buton aktivizimi ne elektrode	Copë	30
169	Elektroda njeperdorimeshe per tiroidektomi	Instrument ne per ngjitjen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm; te jete ne forme gershere; me maje te harkuar; gjatesia totale 18.8 cm; gjatesia e ngjitjes 16.5mm; gjatesia e prerjes 14.7mm	Copë	30
170	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut , 23cm	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade, gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja.	Copë	10
Dezinfektante Mjekesore dhe Kirurgjikale				
171	Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehyde-Formaldehyde	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfshire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfshire HBV/HIV)Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per	litra	500

		perzierjen dhe perftimin e solucionit te gatshem per perdorim. Permbajtja: min. 2% glutaraldyhe, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve		
172	Solucion i koncentruar enzimatik	Per pastrimin e mbetjeve ne instrumentat mjekesore-kirurgjikale, vecanerisht endoskopet dhe instrumentat mjekesore dhe kirurgjikale me pjese te levizeshme dhe lumene te vegjel. Te kete baze enzimatiqe. Te furnizohet si koncentrat per tu holluar me uje ne masen 1-3% . Te jete efektiv per pune ne uje me temperature te zakonshme (~20°)	litra	100
173	Drape dezinfektuese	Drape higjienike ter gatshme per perdorim, te imprenjuara me solucion pastrues dhe dezinfektues. Per pastrimin dhe dezinfektimin e siperfaqeve te vogla te pajisjeve dhe instrumentave mjekesore; 100-200 cope / kuti .	Copë	1,000
174	Detergjent	Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti permban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isotiazolinone Magnesio Cloruro , perdoret duke u tretur 20 ml ne 1 liter uje	litra	500
175	Xhel shumeperdorimsh	Per desinfektimin e duarve te personelit mjekesor , Antiseptik i shpejte dhe efektiv, i gatshem për ta përdorur , pa nevojën perdorimin e ujit per shplarje. Te furnizohet ne ene 1 - 3 liter te pajisura me dozator.	litra	500
176	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët per desinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshem për ta përdorur	litra	1,000

177	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të te plageve te jashtëme , i gatshëm për ta përdorur	litra	700
178	Formaldehid	Solucion 35-40%	litra	120
180	Benzalchonium chloride 10%	Benzalconium chloride 10%. Per dezinfektimin dhe pastrimin e siperfaqeve. Efekt baktericid, mycobaktericid, antiviral.	litra	200

Afatet e lëvrimit:

Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda nje periudhe 24 mujore, si me poshte:

Periudha 12 mujore e I-re

- Deri në 35% të sasive - 4 mujorin e I
- Deri ne 35 % të sasive - 4 mujorin e II
- Deri në 30 % të sasive - 4 mujorin e III

Periudha 12 mujore e II-te

- Deri në 35% të sasive - 4 mujorin e I
- Deri ne 35 % të sasive - 4 mujorin e II
- Deri në 30 % të sasive - 4 mujorin e III

Përfundimisht këtij përcaktimi, autoritetet kontraktore mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për artikujt e listës së planifikuar, që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në cdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do të përcaktohen sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

III.3.4. Referuar nenit 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Nenit 3, “Parime të përgjithshme” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”

Nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.3.5. Referuar nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet

në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.3.6. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

“3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.3.8. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriterë të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisht të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave, por KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave për artikujt e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, nuk është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe me volumin dhe përmasat e kontratës dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe kthimit të përgjigjes lidhur me këtë pretendim, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë, se përse është e nevojshme paraqitja e mostrave të caktuara për këtë procedurë prokurimi. Mostra në vetvete ka qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, qëllim i cili përmbushet nga operatorët ekonomikë me paraqitjen e skedës teknike ose katalogëve si dhe të ofertës teknike, të cilët autoriteti kontraktor në

mënyrë alternative i ka kërkuar si kusht për kualifikim në pikën 7 dhe 8 të pikës 2.3. të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se verifikimi i përputhshmërisë së specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor me specifikimet teknike të artikujve, sigurohet nga operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit edhe përmes paraqitjes së skedës teknike apo katalogut siç është përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 9 të pikës 2.3. të kriterëve të veçanta të kualifikimit, lidhur me paraqitjen e mostrave për artikujt e caktuar, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me qëllimin e lex specialis si dhe rregullat e prokurimit publik, të cilat kanë si synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri për kualifikim nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi..

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK për modifikimin e specifikimeve teknike të materiale mjekimi kirurgjikale të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se,

III.4.1 Në Shtojcën 6, “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumentave të tenderit objekt ankimi,, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon::

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

- **LOT 2 MM2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore**
-

Nr.	Emërtimi i artikujve	Specifikimet Teknike	Njësia	Sasia per 24 muaj
Materiale mjekimi per Anestezi -reanimacion				
1	Kanjule intravenoze	14G , me valvol	Copë	100
2	Kanjule intravenoze	16G , me valvol	Copë	500
3*	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë	70,000
4*	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë	25,000
5*	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë	40,000
6	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë	4,000

8	Age spinale e zakonshme	22G - 26G, L=7-9 cm	Copë	2,500
9	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë	500
11	Kateter zgjatues venoz	Zgjatues 120-150cm	Copë	1,000
12	Ventil tre-rrugesh		Copë	200
13	Ventil tre-rrugesh me zgjatues	Tub 10-25 cm gjatesi	Copë	400
15*	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë	19,000
16	Kateter Foley 3-rruge	Silikon Foley Ped-adult 3-rruge	Copë	300
18	Sonde gastrike		Copë	2,000
19	Sonde rektale		Copë	50
20	Sonde rektale pediatrike		Copë	50
21*	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë	19,000
22	Qese urine pediatrike	jo më shumë se 1000ml, me valvol	Copë	200
23	Age spinale pediatrike		Copë	20
24	Set aspirimi kanjule me tub	1.8 deri 2.5 m+kanjule 26X6 mm	Copë	2,500
26	Kanjule trakeostomie 100% silikon	7,7.5,8,8.5 mm me ballon	Copë	30
31	Kateter urinar	2 rrugesh, 12 ch, balon 10 ml	Copë	200
32	Kateter urinar	2 rrugesh, 16 ch, balon 30 -50 ml	Copë	200
35	Kateter urinar	2 rrugesh, 14 ch, balon 30-50 ml	Copë	200
37	Sonde blakemore	Nr. 16, 20	Copë	140
38	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidrosilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm	Copë	500

40	Sfungjer Nazal me fill	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm	Copë	20
41	Splint Intranazal Silikoni	Splint Intranazal Silikoni me tub ajrimi	Copë	20
Shiringa, Age				
42	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë	3,000
43*	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë	300,000
44*	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë	360,000
45*	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë	400,000
46*	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë	40,000
47	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G	Copë	3,000
48	Age 18G	sterile	Copë	300
49	Age 20G	sterile	Copë	300
57	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile me gryke hinke	Copë	1,000
Materiale nje perdorimeshe per kirurgji				
59	Perparese vizitoresh	Perparese vizitoresh me peshe jo me pake se 20 gr , me minge elastike dhe jake rrethore	Copë	2,000
60	Maske kirurgjikale	Cope e pathurur me 3 shtresa, celluloze , poliester , fiber , koficenti i filtrimit $\geq 99\%$, me pershtates per hunden dhe lidhese , dimesionet 90 mm x 180 mm , pesha 2.8 gr	Copë	5,000
63	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike	Copë	2,000
66	Beze kirurgjikale sterile 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me permasa te copes 75x90cm	Copë	3,000
70	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetike) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me	Copë	200

		shtrese te trashe qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent		
Materiale qepes kirurgjikale				
Sutura mendafshi				
72	Silk -USP 1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	7,000
73	Silk -USP 0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	7,000
74	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë	300
75	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-35	age 1/2 rrethore	Copë	2,000
76	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40	age 1/2 rrethore	Copë	500
77	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-25	age 1/2 rrethore	Copë	500
78	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore	Copë	3,000
79	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese	Copë	500
80	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë	500
81	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	500

82	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-26	me age 1/2 rrethore	Copë	100
84	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	100
85	Silk -USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 16-20	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	60
93	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore prerese	Copë	1,000
Sutura Sintetike te Absorbueshme				
94*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	13,000
95*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	13,000
96*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë	17,000
97*	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë	17,000
98	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë	7,000

99	Poliglctin ose PGA , Coated-USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë	400
100	Poliglctin ose PGA , Coated-USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë	200
117	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting	Copë	12
118	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point	Copë	12
119	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point	Copë	12
Suture Polipropileni				-
120	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë	1,500
121	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50 mm	1/2 rrethore shpuese	Copë	500
123	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë	2,000
124	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 40-50cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	600

125	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë	6,000
126	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	600
127	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë	4,500
128	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	500
129	Polypropylene-USP4-0, Gjatesia fijes 60-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë	400
131	Polypropylene-USP 5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë	120
Sutura PVDF				
140	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 6/0	0.7 metric, reverse premium cutting, 12mm 3/8 circle, length 45 cm	Copë	120
Sutura PVDF e verdhe				-
146	Monofilament PVDF I verdhe e pa absorbueshme USP 2/0	3 metric, reverse cutting, 25mm 1/2 circle, length 76 cm	Copë	60
147	Monofilament PVDF I verdhe, e pa absorbueshme USP 4/0,	1.5 metric, A-cute taper, 20mm 1/2 circle, length 90 cm	Copë	60
148	Monofilament PVDF I verdhe, e pa absorbueshme USP 3/0,	2 metric, Round bodied taper, 16mm 1/2 circle, length 45 cm	Copë	60

149	Shirit Polyester i pa absorbueshme per serklazh 0.5cm	Per tarjtimin e qafes se mitres gjate shtatezanise sipas teknikes Shirodkar, gjatesi 50cm, me dy age 65mm ne te dy anet e shiritit	Copë	80
Mesh kirurgjikal per hernia-laparaskopi				
151	Mesh e vogel	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2	Copë	120
152	Mesh e madhe	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron	Copë	60
Sutura per okulistike				
156	Polyamide 6 dhe 66- USP 10-0, Gjatesia e fijes 30-45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm	spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double	Copë	60
157	Polyamide 6 dhe 66- USP 9-0, Gjatesia e fijes 30-45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm	spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double	Copë	30
158	Polypropylene-USP 6-0; Gjatesia e fijes 75 cm, Dimensioni i ages 13 mm	3/8 rrethore	Copë	48
Te tjera materiale qepes kirurgjikale				
160	Stapler	Linear 30/60/90 mm	Copë	20
161	Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm	Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekendore, anvili te jete me mekanizem tilt	Copë	24
162	Stapler Endoskopie	Stapler njeperdorimesh i rikarikueshem, gjatesia e boshtit 16cm dhe 6cm, artikulacion +/-45 grade dhe me 11 pozicione	Copë	3

163	Stapler linear preres	60-80 mm	Copë	10
165	Kartrixh per Stapler Endoskopie	Kartrixh i artikuluar me tre rrjeshta me lartesi te ndryshme (2;2.5;3mm dhe 3;3.5;4mm), 30mm;45mm;60mm	Copë	30
166	Aplikator automatik klipash	Medium	Copë	50
167	Elektroda, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut ne forme gershere	Elektroda, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm. Prerje (devaskularizimi i organeve), me maje te harkuar, thike te integruar te pavarur nga ngjitja, me buton aktivizimi ne elektrode	Copë	30
169	Elektroda njeperdorimeshe per tiroidektomi	Instrument ne per ngjitjen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm; te jete ne forme gershere; me maje te harkuar; gjatesia totale 18.8 cm; gjatesia e ngjitjes 16.5mm; gjatesia e prerjes 14.7mm	Copë	30
170	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut , 23cm	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade, gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja.	Copë	10
Dezifektante Mjekesore dhe Kirurgjikale				
171	Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehyde-Formaldehyde	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfshire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfshire HBV/HIV)Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perftrimin e solucionit te gatshem per perdorim.Permbajtja: min. 2% glutaraldyhe, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve	litra	500
172	Solucion i koncentruar enzimatik	Per pastrimin e mbetjeve ne intrumentat mjekesore-kirurgjikale, vecanerisht endoskopet dhe instrumentat mjekesore dhe kirurgjikale me pjese te levizeshme dhe lumene te vegjel.Te kete baze enzimatiqe. Te furnizohet si koncentrat	litra	100

		per tu holluar me uje ne masen 1-3% . Te jete efektiv per pune ne uje me temperature te zakonshme (~20°)		
173	Drape dezinfektuese	Drape higjenike ter gatshme per perdorim, te imprenjuara me solucion pastrues dhe dezinfektues. Per pastrimin dhe dezinfektimin e siperfaqeve te vogla te pajisjeve dhe instrumentave mjekesore; 100-200 cope / kuti .	Copë	1,000
174	Detergjent	Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti permban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isotiazolinone Magnesio Cloruro , perdoret duke u tretur 20 ml ne 1 liter uje	litra	500
175	Xhel shumepedorimsh	Per desinfektimin e duarve te personelit mjekesor , Antiseptik i shpejte dhe efektiv, i gatshem për ta përdorur , pa nevojën perdorimin e ujit per shplarje. Te furnizohet ne ene 1 - 3 liter te pajisura me dozator.	litra	500
176	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët per desinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshem për ta përdorur	litra	1,000
177	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të te plageve te jashtëme , i gatshëm për ta përdorur	litra	700
178	Formaldehid	Solucion 35-40%	litra	120
180	Benzalchonium chloride 10%	Benzalconium chloride 10%. Per dezinfektimin dhe pastrimin e siperfaqeve. Efekt baktericid, mycobaktericid, antiviral.	litra	200

-
- Materialet e mjekimit duhet të permbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC ose FDA. Ato duhet të jenë të markuara CE ose FDA në momentin e lëvrimin të mallit.

- Afati i skadencës: jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.
- Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.
- Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.5.4. Në nenin 36, “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP-ja gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet, si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve

kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për siguri të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larinë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese."

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" është përafshuar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar". Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" parashikohet se: "Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim." Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se nëse një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e

autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë me reputacion.

III.4.6. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.4.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK mbi modifikimin e specifikimeve teknike për produktet numër 117; 118; 119; 171; 174

117. *Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting*

118. *Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point 64 Beze hidroshel Beze e sfungjerte hidropolimere, hidrosheli me perberje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buze adezive poliakrilat. Permasa 15x15 cm;*

119. *Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point.*

161 *Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekendore, anvili te jete me mekanizem tilt*

170 *Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut , 23cm Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade,*

gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja. të procedurës së prokurimit objekt - ankimi,” , Komisioni Prokurimit Publik vëren se:

III.4.7.1. Autoritetit Kontraktor me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave i ka pranuar pjesërisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues duke ndryshuar këto kritere si më poshtë vijon:

117. Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni ose ekuivalent, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting

118. Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni ose ekuivalent, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point 64 Beze hidroshel Beze e sfungjerte hidropolimere, hidrosheli me perberje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buze adezive poliakrilat. Permasa 15x15 cm;

119. Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0 Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni ose ekuivalent, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijos dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm +/-10%, age 1/2, 37mm +/-10%, taper point

161 Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm +/-10%, dhe me kapese 4.8mm ne forme drejte kendore, anvili te jete me mekanizem tilt

170 Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut , 23cm Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade, gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm +/-10%, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me pajisjen e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të

përcaktojë, specifikime teknike dhe parametra të caktuara, me qëllim performancën sa më të mirë të materialeve të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike, duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, dhe në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se kriteret dhe/ose specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar.

Në rastin konkret lidhur me pretendimet e ankimuesit dhe pas modifikimit të **artikujve 117, 118 dhe 119**, KPP gjykon se për specifikimin teknik të këtyre artikujve autoriteti kontraktor ka përcaktuar edhe fjalën “ose ekuivalente” në kuptim të asaj cfarë parashikon dhe neni 4 “Përkufizime” pika 7 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, mbi ekuivalencën ku përcaktohet se: “7. “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.”. Ndërsa për artikujt 161 dhe 170 ka përcaktuar hapjen e diapazonit mbi përmasat për këto produkte me **+/-10%**.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ndryshimet e specifikimeve teknike për artikujt 117, 118, 119, 161 dhe 170 nga ana e autoritetit kontraktor janë hartuar në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’, i ndryshuar dhe vlerësohen nga Komisioni si pranimit plotë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues.

Sa më sipër, Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime të operatorit ekonomik “SoLed” SHPK.

III.4.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK mbi modifikimin e specifikimeve teknike për produktet nr. 171 (konkretisht për përbërësin 'Formaldehyde') dhe nr. 174 (për përbërësin '2% Isotiazolinone Magnesio Cloruro'), vërehet

se në Shtojcën nr. 6, 'Formulari i Specifikimeve Teknike', të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar si vijon:

Artikulli 171: 'Dezinfektant instrumentash me bazë Glutaraldehyde-Formaldehyde. Për dezinfektimin manual të instrumenteve kirurgjikale, përfshirë endoskopët dhe fibroskopët. Të ketë efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (përfshirë HBV/HIV). Të furnizohet si komplet me solucion të paaktivizuar dhe aktivizuesin për përzierjen dhe përfitim të solucionit të gatshëm për përdorim. Përmbajtja: min. 2% glutaraldehyde, etj. Të furnizohet si solucion i gatshëm për përdorim (max 5 litra/enë). Të ketë referenca përdorimi nga firmat e njohura të endoskopëve dhe fibroskopëve.

'Artikulli 174: 'Detergjent. Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshëm të të gjitha sipërfaqeve, planeve sanitare, dyshemeve dhe objekteve. Dezinfektanti përmban 10% Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2% Isotiazolinone Magnesio Cloruro; përdoret duke u tretur 20 ml në 1 litër ujë.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk ka argumentuar teknikisht se si këto dy specifikime janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Gjithashtu, nuk është provuar se si këto kërkesa ngushtojnë konkurrencën apo favorizojnë një markë të caktuar. Përkrahimi “Dezinfektant instrumentash me bazë Glutaraldehyde-Formaldehyde” dhe nuk përbën një markë tregtare, por është një emërtim i pastër kimik që specifikon lëndët aktive (përbërësit) e produktit. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën ligjore të përcaktojë kriteret dhe specifikimet teknike sipas nevojave të tij, duke kërkuar që produktet objekt prokurimi të përmbushin standardet më të larta të cilësisë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret/specifikime teknike të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK për ndarjen në lot të veçantë të produktit numër **37 “Sonde blakemore Nr. 16, 20”**, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, me pretendimin se “....pasi produkti i kërkuar korrespondon me një produkt shumë specifik, i cili në tregun shqiptar dhe rajonal disponohet ekskluzivisht nga shoqëria Euromed Shpk, me prodhues Create Medic. Nga verifikimet dhe informacionet e disponueshme në treg rezulton se prodhuesi tjetër që mund të ofrojë produkte të ngjashme nuk disponojnë certifikimin CE të vlefshëm për këtë produkt, çka i bën ato produkte të papranueshme për përdorim dhe ofertim në procedura publike sipas kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi për pajisjet mjekësor....”, Komisioni vëren se:

III.4.9.1. Autoritetit Kontraktor me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nuk e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik duke argumentuar ndër të tjera se Argumentimi i paraqitur nga operatori ekonomik mbi pamundësinë e sigurimit të produktit “Sonde Blakemore Nr. 16,20” nuk qëndron as teknikisht dhe as ligjërisht, pasi bie ndesh me aktet objektive të tregut dhe me kuadrin rregullator në fuqi. Nga pikëpamja teknike, Sonda Blakemore është një material mjekësor standard, e përdorur gjerësisht në trajtimin emergjent të hemorragjive gastroezofageale. Ky material nuk përbën një produkt unik (eksperimental apo i personalizuar, por një artikull i zakonshëm i prodhuar nga më shumë se një prodhues në tregun ndërkombëtar. OE ankimes nuk ka paraqitur asnjë prove ligjore se km e bazon pretendimin e tij se ky produkt e kufizon garen por argumenton te kunderten duke pohuar se ka prodhues por nuk mund te siguroje prodhuesin që ploteson kriteret e kualifikimit mbi certifikimin CE. SRSH ne rolin e AK perfitues, pas nje analize te specifikimeve teknike te artikullit nr. 37 konstaton se nuk eshte perdorur asnje marke, patente apo emer i vecante tregetar qe do ta bente artikullin unik dhe te pa aksesueshem nga operatore apo prodhues te ndryshem. Termi “blakemore” i eshte vendosur materialit mjekesore ne nder te shpikesit te ketij materiali. Ne specifikimet teknike nuk eshte dhene asnje karakteristike specifike e detajuar duke e lene mjaftueshem te hapur konkurencen per kete artikull. Vetë deklarimi i operatorit ekonomik se egziistojnë disa prodhues globalë për këtë artikull rrëzon pretendimin për mungesë të produktit në treg. Egzistenca e disa prodhuesve është provë e mjaftueshme se produkti është i aksesueshëm, ndërkohë që diferencat në statusin e certifikimit CE, marrëdhëniet e shpërndarjes apo strategjitë tregtare nuk janë elementë teknikë të produktit, por çështje të brendshme të operatorit ekonomik Me tej SRSH ne rolin e AK perfitues ne kete procedure prokurimi konstaton se Operatori i Blerjeve te Perqendruara nuk e ka kufizuar kerkesen e certifikimit vetem ne CE sic pretendon OE por ka dhene opsionin qe materialen mund te jene te Certifikuara CE ose FDA. OE nuk ka paraqitur asnje prove nga ndonje Institucion Kombetar, European apo nga Shtetet e Bashkuara te Amerikes se asijje prodhues tjetër përveç Createmedic mund të certifikojë një artikull të tillë. Pretendimi i OE ankimes nuk qëndron edhe për faktin se pas një kërkimi të thjeshtë në internet, rezulton se ka më shumë se një prodhues në treg sic janë Kingsun, JD Meditech, Advin Healthcare, Cretaemedic, BD etj. Gjithashtu, procedura e prokurimit publik është përzgjedhur si e hapur mbt kufirin e lane monelar gjë që në këtë procedure prokurimi mundet të marrin pjesë të gjithë operatorit ekonomik në tregun e bashkimit europian të rajonit dhe më gjerë.....”

III.4.9.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,

parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.4.9.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.9.4. Neni 39 i ligjit nr.162/2020 Për prokurimin publik parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*
- 2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet. Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.*
- 3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.*

III.4.9.5. Neni 42 i VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote*

sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve. 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

III.4.9.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është blerja nga ana e autoritetit kontraktor materialeve mjekimi kirurgjikale. KPP vëren, se sasia e mallrave është relativisht e konsiderueshme. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se ankimuesi kërkon ndarjen në lote të procedurës së prokurimit, konkretisht vetëm të artikullit nr. 37, duke e ndarë lot më vete me pretendimin se këto produkte prodhohen vetëm nga një prodhues i vetëm dhe se ky prodhues ka një distributor në vendin tonë. Nga ana tjetër, sipas pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pranon se ky produkt nuk ka produkte ekuivalent, fakt të cilin autoriteti kontraktor e përgenjështon në vendimin e KSHA-së duke përmendur dhe kuivalentët e këtyre tre produkteve. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo, e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakta. Gjithashtu, referuar nenit 39 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, autoriteti kontraktor në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.. Autoriteti kontraktor në vendimin e KSHA-së ka argumentuar se Spitali Rajonal Shkodër në rolin e AK përfitues konstaton se OBP ka publikuar një procedure me 3 lote të grupuara sipas natyrës së materialeve dhe ndarja e cdo artikulli në lot të vecantë sipas interesave të operatorëve ekonomikë mund të sjellë dështim të procedurës së prokurimit për shkak të mos shfaqjes interes të operatorëve ekonomikë si rrjedhojë e vlerës së ulët për Lotet me një artikull. Spitali Rajonal Shkodër në rolin e AK përfitues vlerëson që operatorët ekonomikë vendas apo të huaj

do duhet të mbajnë në konsideratë edhe aspektet që i takon kërkimeve për të dorëzuar një ofertë me një nga format që njeh ligji i prokurimit publik. KPP vlerëson, se mosndarja në lote e procedurës së prokurimit në rastin konkret nuk e ul konkurrencën në radhët e operatorëve ekonomikë dhe nuk pengon pjesëmarrjen e biznesit të vogël, pasi referuar mallrave objekt prokurimi konstatohet se pjesa më e madhe e tyre i përketin të njëjtës fushë dhe pothuajse kanë të njëjtën tipologji. Ndërkohë që nga ana tjetër, ankimuesi ka dështuar të argumentojë kërkesën për ndarjen në një lotë të kësaj procedure prokuruese, duke e lidhur këtë vetëm me artikullin nr. 37 me pretendimin se prodhuesit e këtij artikulli nuk plotësojnë certifikimin CE. Ajo që KPP konstaton është se në dst mallrat (artikujt) mund të jenë të certifikuar CE ose FDA. Sa më lart, KPP e gjen të drejtë vendimin e autoritetit kontraktor, për mosndarjen e procedurës në lote, pasi kjo nuk e ul konkurrencën dhe as nuk pengon pjesëmarrjen edhe të biznesit të vogël, si dhe i jep garanci autoritetit për mos dështim të kësaj procedure, ndaj rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur – Mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-84346-05-05-2026 me objekt: “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote, për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit 111,841,711.14 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë pikë katërmëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1,167,450.01 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë zero një) euro pa TVSH, LOT 2 - MM2 “Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, me nr. REF-84350-05-05-2026 me fond limit 56,985,144.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e

katër) lekë pa TVSH ose 594,834.49 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur – Mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-84346-05-05-2026 me objekt: “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote, për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit 111,841,711.14 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë pikë katërmëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1,167,450.01 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë zero një) euro pa TVSH, LOT 2 - MM2 “Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, me nr. REF-84350-05-05-2026 me fond limit 56,985,144.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH ose 594,834.49 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
7. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

